

VENDIM
Nr. 24/2019

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR TË
KONTROLLUAR LIGJSHMËRINË E VEPRIMEVE TË ORGANEVE TË PUSHTETIT
EKZEKUTIV DHE TË INSTITUCIONEVE TË TJERA SHTETËRORE NË PAJISJEN
E Z. GENT CAKAJ ME “CERTIFIKATË TË SIGURIMIT TË PERSONELIT” DHE
HETUAR NËSE Z. CAKAJ KA PASUR QASJE NË INFORMACIONE TË
KLASIFIKUARA PA QENË I PAJISUR MË PARË ME KËTË DOKUMENT NË
CILËSINË E TIJ SI ZËVENDËSMINISTËR PËR EVROPËN DHE PUNËT E
JASHTME APO DETYRA TË TJERA SHTETËRORE**

Në mbështetje të neneve 7, 77 dhe 78, të Kushtetutës, të neneve 5, 6, 8 e 9, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një të katërtës së deputetëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh, për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve administrative të organeve të pushtetit ekzekutiv dhe të institucioneve të tjera shtetërore në pajisjen e z. Gent Cakaj me “Certifikatë të sigurisë” dhe hetuar nëse z. Cakaj ka pasur qasje në informacione të klasifikuara pa qenë i pajisur më parë me këtë dokument, në cilësinë e tij si zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme apo detyra të tjera shtetërore.

II. Ky hetim do të synojë mbrojtjen e sigurisë kombëtare, shtetin e së drejtës dhe demokracinë funksionale, me qëllim parandalimin e pasojave negative për shtetin, qytetarët dhe interesin publik, si dhe nxjerrjen e përgjegjësive konkrete institucionale.

III. Objekti i punës së Komisionit Hetimor, është:

1. Verifikimi i ligjshmërisë dhe i veprimeve të institucioneve shtetërore në pajisjen e z. Gent Cakaj me “Certifikatë të sigurimit të personelit (CSP)”, nga DSIK-ja.

2. Roli i Këshillit të Ministrave, Kryeministrit apo ministrave përgjegjës në ndjekjen dhe zbatimin e procedurave dhe rregullave për garantimin e informacionit “sekret shtetëror” dhe të procedurave për pajisjen e z. Cakaj me CSP.

3. Arsytet e mospajisjes me CSP të z. Gent Cakaj, për 7 muaj dhe verifikimi i pasojave që ka sjellë për sigurinë kombëtare dhe angazhimet e Shqipërisë, si vend anëtar i NATO-s dhe vend kandidat për në BE.

4. Verifikimi nëse autoritetet përgjegjëse kanë lejuar z. Cakaj të administrojë dhe përpunojë informacion të klasifikuar, pa qenë më parë i pajisur me “Certifikatë sigurie”.

IV. Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese dhe përcaktimet e ligjit nr. 8457, datë 11.12.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, të ndryshuar, veçanërisht parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si dhe duke respektuar dhe duke mos mbivendosur kompetencat e organeve të drejtësisë.

V. Komisioni Hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në seancë plenare rekomandime në lidhje me nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, ndryshime apo miratime ligjesh dhe, sipas rastit, njoftimin e prokurorisë për marrjen e masave të mëtejshme ligjore.

VI. Komisioni Hetimor Parlamentar përbëhet nga 9 anëtarë, si më poshtë:

1. Enkelejd Alibeaj	kryetar	(PD),
2. Ermonela Felaj	zëvendëskryetare	(PS),
3. Xhemal Qefalia	anëtar	(PS),
4. Klotilda Bushka	anëtare	(PS),
5. Alket Hyseni	anëtar	(PS),
6. Spartak Braho	anëtar	(PS),
7. Ervin Salianji	anëtar	(PD),
8. Xhemal Gjunksi	anëtar	(PD),
9. Luan Rama	anëtar	(LSI).

Kryetari dhe të gjithë anëtarët e Komisionit Hetimor duhet të jenë të pajisur me CSP të kategorisë “sekret”.

VII. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 3-mujor nga miratimi i këtij vendimi.

VIII. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit që menjëherë të caktojë mjediset dhe mjetet e punës së komisionit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi për sigurimin e informacionit të klasifikuar, si dhe personelin e nevojshëm, duke vënë në dispozicion edhe ekspertë juristë, të cilët, gjithashtu, duhet të jenë të pajisur me CSP të kategorisë “sekret”.

IX. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të marrë masa për zbatimin e vendimit të Kuvendit dhe të urdhrave të Kryetarit të Kuvendit për mbarrëvajtjen e punës së komisionit, si dhe krijimin e kushteve të nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të tij.

X. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 31.1.2019.